



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR.21, PARAQITUR NË KQZ
NË DATËN 05.07.2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 09.07.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: **Partia Bindja Demokratike**

OBJEKT: Për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në Bashkinë Libohovë.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", neni 129, pika 1, 3, germa (a) dhe neni 126, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Subjekti zgjedhor Partia Bindja Demokratike, ka depozituar pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në Regjistrin e Ankimeve Zgjedhore, me Nr.21 regj, datë 05.07.2019.

Në mbledhjen e datës 06.07.2019, ora 11:00 pas relativitetit të z.Denar Biba, dhe diskutimit të përfaqësuesve të partive politike u konstatua se kjo kërkesë ankimore nuk i përmbante elementet e formës duke mos plotësuar një nga kërkesat e nenit 126, pika 2 të Kodit Zgjedhor.

Për këtë arsye, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi me Vendimin nr.962 datë 06.07.2019 "Kthimin për plotësim të kërkesës ankimore nr.21 , paraqitur në KQZ në datën 05.07.2019", sipas nenit 129 pika 3 "c" e Kodit Zgjedhor.



Neni 129 pika 4 i Kodit Zgjedhor parashikon qe subjekti ankues duhet të bëjë plotësimin e kërkesës ankimore dhe ta depozitojë atë në KQZ brenda 24 orëve nga marrja e vendimit. Subjekti ankues, Partia Bindja Demokratike brenda afatit ligjor dhe sipas kërkesave të vendimit të KQZ-së ka depozituar në KQZ kërkesën ankimore të plotësuar.

Në mbledhjen e datës 09.07.2019, ora 10:00 pas relatimit të z. Denar Biba, u verifikua që plotësimi i dokumentacionit të Kërkesës Ankimore dhe rezultoi se Kërkesa Ankimore është në përputhje me parashikimin e Nenit 129 pika 4 të Kodit Zgjedhor. Sa më sipër Kërkesë Ankimore i plotëson elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130. Referuar nenit 129 pika 3, germa a, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, KQZ duhet të vendos kalimin e kërkesës për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 21, pika 1, nenin 126, pika 2, nenin 129, pika 1, 3, germa "a", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Kalimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr.21, datë 05.07.2019, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Bindja Demokratike.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 10.07.2019, në orën 11:40.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

